



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 30, datë 03.12.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“GODINA BANIMI 1-2 KATE DHE SHËRBIMI ME MUR RRETHUES”,**  
**ME VENDNDODHJE NË CURRILA, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Z. Adlei Likmeta, Z. Dorian Baba, Z.Florenc Rama, Z.Virgjil Kazanxhiu, Z. Ilia Traja dhe Znj. Merita Traja, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godina banimi 1-2 kate dhe shërbimi me mur rrethues”, me vendndodhje në Currila, Bashkia Durrës, me zhvillues Z. Adlei Likmeta, Z. Dorian Baba, Z.Florenc Rama, Z.Virgjil Kazanxhiu, Z. Ilia Traja dhe Znj. Merita Traja.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Durrës, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


**BELINDA BALLUKU**

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the perimeter and "TIRANE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text "REPUBLIKA E ALBANIËS" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" around the perimeter, and "MINISTRIA E BASHKËVEPRIMËS" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.